

**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail: [contact@pallatirinese.com](mailto:contact@pallatirinese.com)

www.pallatirinese.com

**Dt: 04.03.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 10, paragrafit 10.5 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies me qira të hapësirave kulturore, sportive dhe ekonomike dhe kontrata e shtëpisë, e datës 22.06.2023, pas identifikimit të Departamentit të Administratës për hapësirat e lira dhe bazuar në Vendimin e datës **04.03.2026** të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.me seli në Prishtinë, me datë **04.03.2026**, publikohet kjo:

**FTESË PËR OFERTË**

N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara:

- Personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm),
  - Personat fizik dhe juridik (për depo),
- të aplikojnë për marrjen me qira të hapësirave për një periudhë të caktuar.  
Hapësirat e destinuara për persona juridik – hapësira afariste:

| Nr. | Adresa                                                                                                    | Sipërfaqja            | Çmimi për m <sup>2</sup> |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|--------------------------|
| 1.  | Lok. Nr. 036 / QT19 (ish SIGALI)                                                                          | 69.85 m <sup>2</sup>  | 18.92€ Neto              |
| 2.  | Lok. Nr. 068 / QT34/1 (ish Lifte style)                                                                   | 101.83 m <sup>2</sup> | 11.87 € Neto             |
| 3   | Zyrja 116/2 përballë sallës së vogël (DIGJIT – ALB)                                                       | 34.71 m <sup>2</sup>  | 5.99 € Neto              |
| 4.  | Zyre nr. 06 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal) | 12.28 m <sup>2</sup>  | 10.89 € Neto             |
| 5.  | Zyre nr. 07 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal) | 12.18 m <sup>2</sup>  | 10.89 € Neto             |
| 6.  | Zyre nr. 08 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal) | 11.96 m <sup>2</sup>  | 10.89 € Neto             |
| 7.  | Depo nr. 04 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)                                                   | 64.76m <sup>2</sup>   | 3.58 € Neto              |
| 8.  | Depo nr. 05 (Që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare)                                                   | 70.64m <sup>2</sup>   | 3.58 € Neto              |
| 9.  | Depo ish Garazha që ndodhet në Parkingun e Qendrës                                                        | 72.86m <sup>2</sup>   | 3.58 € Neto              |
|     | DEPOT E SPORTIT                                                                                           |                       |                          |
| 10. | Depo (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të SportitDEPO NEN SHKALL)                   | 112.5 m <sup>2</sup>  | 3.58 € Neto              |
| 11. | Depo e ish Sigurimit (në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)                                         | 27.58 m <sup>2</sup>  | 3.58 € Neto              |
|     |                                                                                                           |                       |                          |
|     |                                                                                                           |                       |                          |
|     |                                                                                                           |                       |                          |
|     |                                                                                                           |                       |                          |

**Vërejtje:**

Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive, pasi ato janë të destinuara për veprimtari sportive.

Afati i kontratës:

Një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal me të dhëna përkatëse;
2. Kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
3. Oferta financiare – çmimi për m<sup>2</sup> (pa TVSH);
4. Të dhënat e arkës fiskale;
5. Vërtetim nga ATK-ja që dëshmon se biznesi është aktiv;
6. Fletëpagesa e aplikimit.

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm:

1. Çmimi më i lartë se sa çmimi fillestar i shpallur për m<sup>2</sup>;
2. Tarifa e aplikimit është 300,00 €, e cila paguhet në xhirollogari:
3. **17-08-0206-000-000-56 (NLB)**
4. **20-33-0002-180-440-76 (TEB)**
5. **2415-1306-0000-2579 (PriBank)**

Tarifa kompensohet me faturën e parë të qirasë.

- Nëse ofertuesi i përzgjedhur terhiqet nga kontrata, tarifa nuk i kthehet.
- Ofertuesve të pazgjedhur, tarifa u kthehet.

Ofertat nuk do të merren parasysh në rastet kur:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm më parë;
2. Oferta nuk përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Oferta arrin pas datës dhe orës së përcaktuar.

Afati i dorëzimit të ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datë **13.03.2026, deri në ora 12:00** në Zyrën e Arkivës – N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:

- Emri i ofertuesit
- Numri i hapësirës
- E-maili zyrtar
- Numri i telefonit

Hapja e ofertave:

Ofertat do të hapen nga Komisioni për Vlerësim në prani të ofertuesve,

10 minuta pas përfundimit të afatit të dorëzimit – pra më **13.03.2026, deri në ora 12:10,** në zyrën e Drejtorisë së N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Vizitat në hapësira:

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat nga **04.03.2026 deri më 13.03.2026 në ora 10:00,**

çdo ditë pune, nga ora 10:00 – 15:00,

duke u lajmëruar te Recepcioni i N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Kërkesa / Aplikacioni mund të merret:

- Në e-mail: [contact@pallatirinese.com](mailto:contact@pallatirinese.com)
- Në uebfaqen zyrtare: [www.pallatirinese.com](http://www.pallatirinese.com)
- Fizikisht në Recepcionin e N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Për më shumë informata, jeni të mirëpritur të kontaktoni me zyrën përkatëse.